

Nisma #zgjidhje

9 shkurt 2021

Zgjidhje për luftimin e varfërisë dhe diskriminimit në Kosovë

GRUAJA ËSHTË PUNËTORE SHUMË E MADHE QË NUK PAGUHET.
LUFTIMI I PABARAZISË FILLON NGA FAMILJA DHE ARSIMI, DHE KËRKON
ANGAZHIM GJITHË QYTETAR DHE POLITIK.

Statistika/të dhëna nga hulumtimet e ndryshme dhe nga debati mbajtur më 5 shkurt 2021 nga #zgjidhje:

Papunësia te gratë sipas të dhënave sillet rreth 80% në Kosovë, prandaj qeveria e ardhshme duhet ta vendos si prioritet parësor punësimin e tyre.

Varfëria është shumë prezente mirëpo dominon më shumë tek gratë, personat me aftësi të kufizuara dhe pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë.

Diskriminimi:

- Asnjë subjekt politik nuk e ka një grua bartëse të listës së tyre për zgjedhjet e 14 shkurtit.
- Asnjë subjekt politik në listën zgjedhore nuk i është ofruar 50% me gra, siç parashihet në ligjin për barazi gjinore.
- Diskriminimi nisat prej shtëpisë, familjes, ndarjes së trashëgimisë, punësimit. Vetëm 4% e familjeve japin trashëgimi për vajzat e tyre.
- Gratë (përfshirë gratë e divorcuara), vajzat, të rinjtë, personat me aftësi të kufizuara, dhe pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë, në përgjithësi janë të diskriminuara.


Diskutimet kryesore në debatin e #zgjidhje:

Kosova ka legjislacion të avancuar që i siguron qytetarëve dhe grupeve të ndryshme shoqërore të drejta të barabarta, por nuk zbatohet si duhet.

- o E drejta për punë është e drejtë elementare. Një grua pret afërsisht 9 vjet për të gjetur një punë. Duke mos pasur mundësi punësimi, gratë ekonomizojnë shumë në ekonomitë familjare. Paga mesatare është shumë e ulët dhe kujdesi për fëmijët, prindërit, të moshuarit, madje edhe në spitale për anëtarët e familjes së tyre është pothuajse në duar të grave. Pagat e ulëta nuk ua mundësojnë dërgimin e fëmijëve në çerdhe. Pastaj ka edhe mungesë të çerdheve - vetëm 6% e fëmijëve në Kosovë shkojnë në çerdhe. Ato publike janë të pakta ndërsa privatet kanë kosto të larta dhe janë të papërbalueshme për familjet. Fëmijët në fshatra pothuajse fare nuk shkojnë në çerdhe.
- o Gratë kanë shumë pak mundësi për të filluar biznes, edhe kur fillojnë një të tillë, në të shumtën e rasteve janë në moshë të shtyrë, jo në moshë të re.
- o Nuk ekziston asnjë rast i diskriminimit në nivele të larta të institucioneve që është gjykuar, pavarësisht se ka dëshmi të mjaftueshme që një gjë e tillë ka ndodhur.
- o Shumë gra kanë dëshmuar lidhshmëri dhe aftësi menaxhuese. Në legjislaturën e kaluar 13 nga deputetet kanë marrë vota, jo si rezultat i kuotës, por si rezultat i punës së tyre. Prandaj, kërkohet që edhe gratë të jenë këmbëngulëse.
- o Institucionet publike duhet të kenë 10% nga pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë, por në këto favorizohen pjesëtarët e një komuniteti të caktuar. Ndërsa janë shumë të diskriminuara komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptian.
- o Personat dhe familjet që jetojnë në varfëri janë më të diskriminuarit p.sh. ka shumë vajza inteligjente dhe të arsimuara nga komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptian por janë të diskriminuara, se kur janë të varfra as punë nuk mund të gjejnë.
- o Romët, Ashkalinjtë dhe Egjiptianët janë të marginalizuar dhe diskriminuar në të gjitha fushat. Nga rreth 40,000 pjesëtar të këtyre komuniteteve, vetëm 994 familje përfitojnë nga asistencë sociale.

Propozime për zgjidhje të mundshme:

1. Paga minimale në Kosovë duhet të rritet në mënyrë që të siguroj minimumin ekzistencial për familjen.
2. Duhet të paguhet praktika në përgjithësi, e në veçanti për gratë.
3. Të garantohet pushimi i lehonisë të paktën 6 mujore, dhe të ketë kontrata të paktën 3 vjeçare, sidomos për gratë.
4. Të sigurohet qëndrim gjithë ditore, çerdhe në fshatra, mundësi punësimi dhe praktike.
5. Të rregullohet me legjislacion profesioni dado, dhe përkujdesja, si dhe shërbimi nga individ për pastrimin/mirëmbajtjen e shtëpive private dhe zyreve. Të rregullohet pagesa e kontributeve pensionale dhe regjistrimi i tyre si të punësuar.
6. Të ndërmerren veprime që ofrojnë incentiva të ndryshme për burrat dhe gratë, që të shohin përfitime nga puna e të dy gjinive.
7. Të krijohet një sistem i sigurimeve në mënyrë që gratë (dhe nënat e divorcuara) të mos diskriminohen në marrjen e pushimeve. Kjo do ta ndihmonte edhe sektorin privat në punësimin e grave, personave me aftësi të kufizuara, dhe të grupeve të ndryshme shoqërore.
8. Të ketë këshillimore nëpër qendrat e ndryshme për punë sociale.
9. Të zbatohen (dhe monitorohet zbatimi) ligjet për shërbyes civil (10% për komunitete jo-shumicë, dhe çdo i 50-ti punëtor për personat me aftësi të kufizuara) dhe kundër diskriminimit, dhe të zbatohen masat afirmative.
10. Të bëhet rishikimi/ndryshimi i kurrikulës shkollore (të hiqet gjuha e urrejtjes).
11. Të sigurohet strehimi për komunitetet Romë, Ashkali, Egjiptian, dhe të fuqizohet monitorimi i mediave pasi që ka pas raste kur mediat kanë publikuar informacion fyes ndaj këtyre komuniteteve.



#zgjidhje është iniciativë e përbashkët vullnetare e organizatave joqeveritare në Kosovë e cila synon që interesat e qytetarëve të jenë në qendër të debatit dhe programeve politike e qeverisëse të subjekteve politike garuese në zgjedhjet e 14 shkurtit. Për të përmbushur këtë synim, **#zgjidhje** do zhvillon ulumtime, analiza dhe debate të ndërmarra në mënyrë të paanshme, të pavarur dhe profesionale

#zgjidhje është iniciativë e përbashkët e Aureola; Balkan Green Foundation; Debate Center – Qendra e Debatit; Global Shapers Community, Prishtina; iCHAT; Iniciativa e Pavarur e të Verbërve të Kosovës; Iniciativa Qytetare Skënderaj; Institute for Development Policy; IZHPS; Kosovo Advocacy Group; Lëvizja FOL; Mundësia, Mitrovicë; OJQ "Gruaja Hyjnore", Gjilan; OJQ "VISION 02", Istog; OJQ Gjeomjedisi; OJQ Nderi, Deçan; OJQ Ndërto të Ardhmen, Prishtinë; Partners Kosova; Qendra e Gruas "ATO", Vushtrri; Roma in Action, Gjakovë; The Balkan Forum.